

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME: ANKETA E PËRFSHIRJES SOCIALE NË KOSOVË¹

Gusht 2020



FINANCIAR NGA
AMBASADA BRITANIKE NË PRISHTINË

Ky raport është përgatitur bazuar në një anketë të kryer në kuadër të projektit “Promovimi i Integritit dhe Pajtit Social” financuar nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe implementuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM).

Gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e IOM-it ose pikëpamjet e Shteteve Anëtare të tij. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë punim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë mendimi nga IOM-i në lidhje me statusin ligjor të cilitdo vend, territor ose zonë, ose të autoriteteve përkatëse në lidhje me kufijtë ose vijat kufitare gjegjëse.

IOM-i i përmbahet parimit se migrimi human dhe i rregullt i shërben si migrantëve ashtu edhe shoqërisë. Si organizatë ndërqeveritare, IOM-i vepron me partnerët e vet në komunitetin ndërkombëtar: për të ndihmuar në ballafaqimin me të gjitha sfidat operative të migrimit; për të zhvilluar më tej kuptimin e çështjeve që lidhen me migrimin; për të nxitur zhvillimin shoqëror dhe ekonomik nëpërmjet migrimit; dhe në mbështetje të dinjitetit njerëzor dhe mirëqenies së migrantëve.

Harta janë dhënë vetëm për qëllime ilustrimi. Kufijtë dhe emrat e treguar si dhe emërtimet e përdorura në këto harta nuk nënkuptojnë miratimin ose pranimin zyrtar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrimin.

© 2020 Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM)

Botues: Organizata Ndërkombëtare për Migrimin
Rruga Lidhja e Pejës 177, 10000 Prishtinë, Kosovë*
Tel .: +383 38 600 521; 600 522; 600 523
Emaili: iompristina@iom.int Uebsajti:
<https://kosovo.iom.int/>

Imazhi i kopertinës: Mural në Kamenicë, projekti artistik SIP, 2018.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme automatike, apo të transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose metodë tjetër, pa leje paraprake me shkrim nga botuesi.

¹ Referimet ndaj Kosovës¹ kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Siç vërehet në shumë vende në të gjithë botën, karakteri shumetnik mund të jetë një cilësi e forcës, duke kontribuar në kreativitetin, qëndrueshmërinë dhe rritjen socio-ekonomike. Mirëpo, kjo mund të çojë në tensione dhe sfida të caktuara që shkojnë përtej vijave etnike, duke rezultuar në paqëndrueshmëri shoqërore dhe politike që kërcënojnë të pengojnë investimet dhe rritjen ekonomike, dhe çojnë në tensione të mëtejshme etnike. Evidencat akademike tregojnë se një çështje kritike që shpesh kufizon besimin dhe bashkëpunimin ndër-etnik janë nivelet e kufizuara të ndërveprimit shoqëror që ndodh ndërmjet anëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike, që nganjëherë rezultojnë nga ndarjet gjeografike, aftësitë e kufizuara gjuhësore dhe programet ose aktivitetet e pakta që janë dizajnuar për të promovuar ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndër-etnik.

Programimi i kohezionit shoqëror të IOM-it në Kosovë bazohet në teorinë e kontakteve ndërgrupore (TKNG). Dekada hulumtimi empirik mbi TKNG-në¹ tregojnë se, brenda kushteve të përshtatshme, programet që lehtësojnë dhe inkurajojnë kontaktin dhe angazhimin ndërmjet anëtarëve të grupeve të ndryshme brenda një komuniteti mund të përmirësojnë ndjeshëm perceptimet dhe qëndrimet e pjesëmarrësve ndaj grupeve të tjera dhe mund të rritin besimin dhe bashkëpunimin ndërgrupor.

Projekti i Kohezionit Social, i mbështetur nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe i implementuar nga IOM-i në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet lokale, synon të kontribuojë drejt një shoqërie më gjithëpërfshirëse për të gjitha komunitetet në Kosovë* duke mbështetur të drejtat e tyre gjuhësore, duke nxitur bashkëpunimin dhe iniciativat e përbashkëta, si dhe raportimin e paanshëm të mediave, duke ndërtuar kështu besimin ndërmjet komuniteteve dhe duke adresuar pikat e fërkimit për hir të pajtimit afatgjatë. Me qëllim të promovimit të ndërveprimit pozitiv ndërmjet të rinjve kosovarë të etnive të ndryshme, u zhvilluan aktivitete të larmishme sociale dhe arsimore, duke përfshirë, ndër të tjera, projekte të artit publik, aktivitete sportive, punëtori për TIK dhe aktivitete në natyrë.

Me qëllimin për të kapur ndikimin e aktiviteteve të kohezionit social që janë kryer në kuadër të projektit dhe gjithashtu për të vlerësuar perceptimet e publikut mbi kohezionin social, u dizajnuan dhe u krye një ushtrim gjithëpërfshirës i anketimit, si me përfutuesit ashtu edhe me publikun e gjerë. Në anketë morën pjesë gjithsej 222 të anketuar, të moshës ndërmjet 15 dhe 24 vjeç, pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme etnike. Prej tyre, 101 ishin përfutues të projektit dhe 121 të anketuar nga popullsia e përgjithshme.

Gjetjet kryesore të këtij vlerësimi janë sa vijon:

— Pjesëmarrësit në projektin e përfshirjes sociale kishin më pak të ngjarë sesa publiku i gjerë të njihnin persona nga një komunitet tjetër etnik. Vetëm 53% e pjesëmarrësve nga komuniteti shqiptar-K njihnin dikë nga një grup tjetër etnik, krahasuar me 74% për publikun e gjerë. Kjo tregon që qasja e projektit po arrin në grupin e paraparë për t'u vënë në shënjestër: ata me më pak përvojë të kontakteve ndërgrupore.

— Në përputhje me pritjet e TKNG-së, personat me nivele më të mëdha ndërveprimi me pjesëtarët e grupeve të ndryshme etnike gjithashtu ishin të prirë të kenë një perceptim më pozitiv të këtyre grupeve. Te komunitetet e tjera etnike jo-shumicë, grup ky i cili tregoi shkallën më të lartë të ndërveprimit me grupe të tjera dhe të njohurive të gjuhës shqipe/serbe, gjithashtu kishte tendencë për opinionet më pozitive ndaj grupeve të tjera, me 77% të të anketuarve në publikun e gjerë duke shprehur opinion pozitiv, në krahasim me 54% dhe 46% për të anketuarit nga komuniteti shqiptar-K dhe komuniteti serb-K, përkatësisht. Shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës të cilët thanë se komunikojnë me grupe të tjera etnike në baza ditore ose javore gjithashtu ishin të prirë të mendojnë më pozitivisht për përvojat e tyre sesa ata që komunikojnë me grupe të tjera vetëm në baza mujore ose më rrallë.

— Pas përfundimit të aktiviteteve, pjesëmarrësit kishin tendencë të shprehnin optimizëm më të madh për të ardhmen e marrëdhënieve ndër-etnike, krahasuar me publikun e gjerë. 68% e pjesëmarrësve nga komuniteti shqiptar-K shprehën besimin se marrëdhëniet ndër-etnike do të përmirësoheshin, krahasuar me 40% brenda popullsisë së përgjithshme; shifrat për grupet e tjera jo-shumicë ishin 62% dhe 31% përkatësisht, ndërsa shumica e pjesëmarrësve nga komuniteti serb-K (58%) shprehën besimin se marrëdhëniet do të mbeten të njëjta.

¹ <https://www.sciencedirect.com/topics/engineering/intergroup-contact>

— Komunitetet e tjera etnike jo-shumicë kishin më shumë të ngjarë të raportonin frekuenca më të larta të ndërveprimit me komunitetet e tjera etnike. Kjo mund të shpjegohet me dinamikën e përbashkët grupore, komunitetet më të vogla do të duhet të angazhohen me komunitetet më të mëdha më shumë për shkak të nevojave/shërbimeve themelore, ndërsa komunitetet më të mëdha (në këtë rast komuniteti serb-K/shqiptar-K) nuk kanë nevojë për ndërveprim me grupe të tjera meqë komuniteti i tyre mund të jetë i vetë-mjaftueshëm për sa i përket nevojave dhe shërbimeve. Rezultate të ngjashme dolën nga Anketa e Kohëzimit Social e kryer në Turqi me komunitetin pritës turk dhe sirianët.

— Pjesëmarrësit konfirmuan se aktivitetet e programit inkurajuan komunikimin ndërgrupor me 92% të pjesëmarrësve nga komuniteti shqiptar-K, 72% nga komuniteti serb-K dhe 94% nga grupet e tjera jo-shumicë, duke treguar që aktivitetet kërkonin njëfarë ndërveprimi deri në shumë ndërveprim, me shumicën dërrmuese të pjesëmarrësve që u shprehën se këto ndërveprime ishin pozitive.

— Dëshmitë mbështetëse nga aktivitetet: Ndonëse vetëm fare pak serbë të Kosovës dhe shqiptarë të Kosovës raportuan të kenë njohuri të gjuhës së njëri-tjetrit, anketa tregon se perceptimi i gjuhëve paraqet një pengesë më të madhe në komunikim. Pjesëmarrësit nga komuniteti shqiptar-K thanë se nuk do të ishin në gjendje të komunikonin me serbët e Kosovës për shkak të gjuhës, ndonëse ata thanë se zotëronin rrjedhshëm gjuhën boshnjake. Refuzimi/mosdija e tyre për të pranuar faktin se njohja e gjuhës boshnjake do të lehtësonte komunikimin në gjuhën serbe konfirmon që pengesat e perceptuara të bazuara në paragjykimet dhe keqinformim mund të jenë më të mëdha sesa çështjet që parandalojnë komunikimin në të vërtetë.

— Arsyeja e dytë më e popullarizuar në radhët e të anketuarve për pjesëmarrje në aktivitetet e përfshirjes sociale ishte shoqërimi, gjë që tregon dëshirën për ndërveprim ndërmjet grupeve dhe nevojën për ndërtimin e mjediseve të tilla. Gjatë diskutimeve në grupet e fokusit në Mamushë, pjesëmarrësit thanë se pas shkollës ata kryesisht qëndrojnë në shtëpi. Ekspozimi i tyre i vetëm ndaj botës së jashtme ishte përmes TV dhe internetit. Kjo është një provë e mëtejshme se të rinjtë u mungojnë mundësitë për t'u takuar me bashkëmoshatarët e tyre dhe për të marrë pjesë në ngjarje shumetnike.

— Dëshmitë mbështetëse nga aktivitetet: Një nga pjesëmarrësit që përdori gjuhë provokuese kundër serbëve të Kosovës në mënyrë kundërthënëse tha se dashuria dhe miqësia nuk njihnin kufij përfshirë përkatësinë etnike. Deklaratat e tij kundërthënëse tregojnë se ai mund të mos jetë i vetëdijshëm për seriozitetin e opinioneve që ai pasqyroi bazuar në ekspozimin e tij ndaj raportimeve mediatike dhe mjedisit të tij shoqëror në lidhje me komunitetet e tjera etnike. Ky lloj i mungesës së mendimit kritik potencialisht mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm dhe për këtë arsye do të duhej të adresohet përmes lehtësimit dhe kultivimit të ndërveprimit ndërpersonal dhe diskutimeve shumetnike.

— “Para se të merrja pjesë në aktivitetet e kohezionit shoqëror të organizuara nga IOM-i, mendoja se të gjithë serbët (e Kosovës) dukeshin të zemëruar dhe armiqësor”.²

— Tema më e vështirë për shumicën e të anketuarve ishte konflikti i vitit 1999. Kjo është veçanërisht domethënëse për faktin se shumica e të anketuarve të përfshirë në këtë vlerësim kanë lindur pas vitit 1999. Kjo demonstroi një nivel të konfliktit të trashëguar/të mësuar brez pas brezi. Sidoqoftë, është premtuese që të rinjtë i gjejnë temat siç janë dallimet etnike, fetare dhe gjuhësore, si relativisht më të lehta për bisedë. Diskutimet konstruktive mbi këto tema potencialisht do të mund të ndërtonin ura për përmirësimin e përfshirjes sociale.

— Dëshmitë mbështetëse nga aktivitetet: ndonëse shumica e të anketuarve raportuan se nuk do të dëshironin të martoheshin me një person nga një komunitet tjetër, gjatë diskutimeve në grupet e fokusit pjesëmarrësit u shprehën se më shumë do t'i preokuponte reagimi nga komunitetet e tyre dhe implikimet e ardhshme në lidhje me familjet ndëretnike, siç është shkollimi i fëmijëve, sesa ideja e martesës me dikë jashtë komunitetit të tyre etnik. Asociimi me komunitete të tjera etnike do të nënkuptonte mosmiratim ose refuzim nga komunitetet e tyre, gjë që do të ishte veçanërisht e vështirë për të rinjtë që varen nga mbështetja dhe udhëzimet e komunitetit.

— Përkundrazi me hipotezën dhe dëshmitë ekzistuese nga programimi i përfshirjes sociale, mosekzistenca/mungesa e ndërveprimit ndëretnik nuk u raportua zakonisht si pengesë për pajtimin në asnjërin prej vlerësimeve. Kjo tregon që komunitetet nuk e kuptojnë mirë ndikimin e ndërveprimit te pajtimi për nga potenciali pozitiv që ka.

2 Të anketuarit nga komuniteti shqiptar-K dhe serb-K kishin më pak të ngjarë ta vlerësojnë si pozitiv ndërveprimin që kanë me njëri-tjetrin. Citati u mor gjatë DGF-ve, kur u shtrua pyetja në lidhje me dallimet e perceptuara ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Deklaratat e kësaj vaje të re tregojnë ashpërsinë e mbulimit mediatic të nxitur nga diskursi politik që ushqehet me dinamikën e konfliktit dhe mungesën e ndërveprimit ndërmjet komuniteteve, veçanërisht komunitetit serb-K dhe komunitetit shqiptar-K.

- Mosbesimi ndërpersonal si rezultat i konfliktit u pa nga të gjitha grupet si pengesa më e madhe unike për pajtimin, duke treguar kështu se mundësitë për ndërveprim pozitiv ndërmjet grupeve janë kritike si një mjet për ndërtimin e besimit.
- Ka opinione me dallime shumë të theksuara lidhur me trajtimin e grupeve në Kosovë, ku 49% e të anketuarve nga komuniteti shqiptar-K deklarojnë se të gjitha komunitetet etnike gëzojnë të drejta të barabarta, ndërsa vetëm 15% e të anketuarve nga komuniteti serb-K e ndajnë këtë mendim. Këto grupe gjithashtu janë të prira të besojnë se secili grup ka dëshira të ndryshme për të ardhmen e Kosovës.

REKOMANDIMET

KRIJIMI I MJEDISEVE TË SIGURTA PËR KONTAKT TË RREGULLT NDËRGRUPOR MIDIS TË RINJVE

- Mbështetja e angazhimit të vazhdueshëm për të mundësuar ndërveprim domethënës midis të rinjve
- Zhvillimi dhe implementimi i aktiviteteve shumëgjuhëshe jashtëshkollore që janë komplementare me plan-programet shkollore në bashkëpunim me autoritetet e nivelit qendror dhe lokal, shkollat, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare:
- Ngjarje të rregullta ndërkulturore pas shkollës (art, sport, gazetari, etj.) të lehtësuara duke u bazuar kryesisht në metodologjinë e ndërvarësisë
- Kurse të rregullta pas shkollës për aftësi ndërpersonale dhe aftësi profesionale (TIK, zanate, udhëheqje, ndërmjetësues konfliktesh, etj.)
- Bashkëpunim pilot ndërkollor në formën e shkollave verore shumëgjuhëshe për fëmijë nga të gjitha grupet e përfaqësuara etnike
- Identifikimi i agentëve për ndryshim dhe mbështetja e tyre për të mobilizuar një komunitet më të gjerë
- Krijimi i mesazheve pozitive
- Monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të implementuara

INVESTIMI NË TRAJNIMIN E PERSONELIT ARSIMOR

Investimi në trajnimin e mësimitdhënësve, prindërve dhe grupeve brenda komuniteteve ka rëndësi jetike:

- Ofrimi i kurseve të gjuhëve zyrtare të Kosovës për mësimitdhënësit
- Ofrimi i trajnimeve mbi mosdiskriminimin, mendimin që merr parasysh konfliktin dhe paragjykimin e pavetëdijshëm për mësimitdhënësit e tanishëm dhe të ardhshëm
- Mbështetja e mësimitdhënësve dhe trajnerëve me plan-programe mësimore për metodologjinë dhe aktivitetet e kohezionit social që duhet të përfshihen në plan-programet e rregullta mësimore
- Zbatimi pilot i “javës përfshirëse” në shkollat me përbërje të ndryshme etnike dhe monitorimi i ndikimit në perceptimin jashtë-grupor

Rekomandime plotësuese për angazhimin e gjerë të komunitetit do të zhvillohen përmes një serie takimesh dhe punëtorish të planifikuara me hisedarë të ndryshëm në nivelin lokal dhe qendror.

